



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 10. 2. 2009, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N -225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rustemi dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Mbledhja e mbikëqyrën: OSBE - Rrezarta Ahmeti (KDI), Blerina Uka (NDI), Nexhat Shatri (Presidenca), Xhemajl Ahmeti - OHCHR, Arbenita Kryeziu dhe Kushtrim Haliti - IO-RKD.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinador, zyrtar i lartë ligjor dhe Sulltane Gashi, zyrtare ligjore.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit për vitin 2008,**
- 3. Shqyrtimi i Planit të punës dhe i strategjisë legjislative për vitin 2009,**
- 4. Shqyrtimi i petitionit nr. o3-1642/Do-983,**
- 5. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua me plotësim.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari - konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 3. 2. 2009.

2. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit për vitin 2008

Ismet Beqiri - theksoi se Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore Persona të Pagjetur dhe Peticione është themeluar në shkurt të vitit 2008 dhe i ka të përcaktuar fushëveprimin dhe objektivat e tij. Fushat që i mbulon Komisioni janë të gjera dhe kërkojnë përkushtim të madh. Anëtarët e Komisionit i përfaqësojnë grupet parlamentare të Kuvendit që janë të përkushtuara dhe shumë profesionale në punën e tyre. Në Komision mbretëron frymë kolegjiale dhe për çështje të rëndësishme vendimet merren me konsensus. Mund të thuhet se Komisioni e përmbylli vitin 2008 me sukses.

Ibrahim Makolli – E përgëzoi hartuesin e Raportit dhe vuri në pah se është bërë një punë e madhe. Kërkoj që në kapitullin IX, ku flitet për vështirësitë në punën e Komisionit, të jepen sqarime përkatëse.

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Sanije Alijaj, Nerxhivane Dauti dhe Drita Maliqi. Ishte konstatim i të gjithëve se detyrat e parapara në planin e strategjisë legjislative u realizuan me sukses.

Komisioni me vërejtjet që u dhanë e miratoi Raportin e punës për vitin 2008

3. Shqyrtimi i Planit të punës dhe i strategjisë legjislative për vitin 2009

Ismet Beqiri – Tha se Plani i ka përcaktuar prioritetet dhe orientimet e Komisionit gjatë këtij viti. Plani është në harmoni me Programin e punës të Qeverisë. I ftoi anëtarët ta merrnin fjalën.

Ibrahim Makolli – Kërkoj të mbikëqyret zbatimin e Ligjit penal për të mitur, i Ligjit për barazi gjinore, i Ligjit për personat me aftësi të kufizuara, i Ligjit për statusin dhe për të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të familjeve të viktimave civile dhe të shtëpive të pleqve etj. Komisioni do të informohet sa po respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut gjatë zbatimit të ligjeve nga organet shtetërore.

Luljeta Shehu – Në diskutimin për Planin e punës të Komisionit për vitin 2009 kërkoj nga Komisioni të përshejtohet procedimi i Projektligjit për familjet, me të cilin rregullohet çështja e të pagjeturve dhe të mos realizohen vizitat derisa Qeveria ta procedojë Projektligjin.

Hajredin Hyseni – Kërkoj të organizohet një konference rajonale, në të cilën do të ftoheshin ekspertë të fushës të të drejtave të njeriut dhe të fushave të tjera. Synimi i kësaj konference do të ishte respektimi i të drejtave të njeriut. Për organizimin e konferencës e kërkoj përkrahjen e OSBE-së ose të donatorëve të tjerë, që do ta mbështetnin financiarisht Komisionin.

Vezira Emrush – Për Planin e punës dhe të strategjisë legjislative kërkoj nga Komisioni që si pikë në plan të përfshihet edhe mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nr 02L37, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik 2006. Propozoi të bëhen vizita në qytete të përziera, në të cilat zbatohet Ligji. Raportin vjetor e vlerësoi pozitivisht dhe e mbështeti idenë e organizimit të konferencës rajonale në të cilën do të trajtoheshin temat e respektimit të të drejtave të njeriut në institucionet shtetërore.

Nerxhivane Dauti – Kërkoj nga Komisionit të përfshihen në Plan vizita studimore që të merret përvoja e disa shteteve për fushat përkatëse.

Drita Maliqi – U angazhua për zbatimin e Ligjit për barazi gjinore dhe e kërkoi ndryshimin e tij. Vuri në pah se në praktikë ka pengesa për zbatimin e tij në nivel lokal. Diskutuan edhe Naim Rustemi, Ibrahim Makolli, Sanije Alijaj dhe Ismet Beqiri.

Komisioni e miratoi Planin pas një debati.

4 Shqyrtimi i petitionit nr. 03-1642/Do-983

Nerxhivane Dauti - Tha se Ismet Syla ka kërkuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, të zbatohet vendimi i KPMK-së nr. 02-197/2008, i 7. 7. 2008 dhe të ricaktohet shërbyes civil në një post në administratën e KK të Mitrovicës, të definuar me vendim të KPMK-së

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e shqyrtoi petitionin nr. 03-1642/Do-983 dhe kërkoi të zbatohet vendimi i KPMK-së. Pas një debati u nxor ky

R e k o m a n d i m

Komisioni i rekomandon Kuvendit të Komunës së Mitrovicës ta zbatojë vendimi nr. 02-197/2008 me të cilin Ismet Syla ricaktohet shërbyes civil në një post në administratën e KK të Mitrovicës.

Kryetari i falënderoi pjesëmarrësit për kontributin që e dhanë.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 30.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri